



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosova**  
**Qeveria/Vlada/Government**

**Ministria e Punëve të Brendshme**  
**Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs**

**Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police**

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës**  
**Generalni Direktor Policije Kosova/General Director of Kosovo Police**



---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**Nr. 01/2024**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.02/2023**  
**MBI MARRËDHËNIEN E PUNËS NË POLICINË E KOSOVËS**

Në mbështetje të nenit 44, paragrafi 2 dhe nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, me qëllim të zbatimit të këtij ligji.  
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**  
**NR. 01/2024 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.02/2023**  
**MBI MARRËDHËNIEN E PUNËS NË POLICINË E KOSOVËS**

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 02/2023 (në tekstin e mëtejshëm: (Udhëzimi bazik).

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Ky udhëzim zbatohet për Policinë e Kosovës.

**Neni 3**

Pas neni 4, shtohet një nen i ri 4A, si në vijim:

**Neni 4A**  
**Himni dhe Marshi i Policisë**

1. Policia e Kosovës ka Himnin dhe Marshin për rastet ceremoniale.
2. Himni dhe Marshi krijohen nga ekspertët ose institucionet e specializuara për këtë fushë dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.
3. Me qëllim të ekzekutimit të Himnit dhe ose marshit të Policisë, Policia themelon Gardën Ceremoniale dhe Orkestrën Frymore.
4. Garda Ceremoniale ka uniformën e saj dalluese dhe është e pajisur me pajisjet e nevojshme për të kryer ekzekutimin e marshit në rastet e ndryshme ceremoniale të nderit apo festive.
5. Mënyra dhe rastet e ekzekutimit të Himnit, angazhimit të Orkestrës Frymore dhe Gardës Ceremoniale më në detaje përcaktohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Kolonel Gazmend Hoxha

---

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë

Datë: 23/05/2024.

Prishtinë